



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FUSHË-ARRËZ  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1564 prot.

Fushë-Arrëz, më 09. 06. 2025

PROCESVERBAL

Bazuar në ligjin 139/2015, i ndryshuar si dhe në Rregulloren për funksionimin e Këshillit Bashkiak Fushë-Arrëz, u mbledh sot, më 09.06.2025, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen jashtë radhe të thirrur nga Kryetari i Këshillit me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë, Z Hil Curri.

Në mbledhje morën pjesë:

- **Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak;
- Këshilltarët: **Bardhok Qafa; Lezina Ceca; Besjana Marku; Franc Doda; Mustaf Pashkaj; Nikolin Sadiku; Pavlin Qafa; Valentin Doçi; Vjollca Tabakaj; Zef Cara;**

( 11 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Gjithashtu në mbledhje merr pjesë Kryetari i Bashkisë, **Z. Hil Curri dhe Zëvendëskryetari, Z. Mikel Qafa.**

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak **specialistët e Bashkisë** që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, **z.Nikolin Bardhoku**:

Përshëndetje të gjithëve! Mirë se keni ardhë në këtë mbledhje jashtë radhe të Këshillit Bashkiak të thirrur nga ana jonë me kërkesën e Kryetarit të Bashkisë, Z. Hil CURRI! Në vijim të njoftimit të fundit zhvillojmë mbledhjen jashtë radhe të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarrjen ( 11 Këshilltarë) e cila plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes, ndaj mbledhjen e Këshillit e deklaroj të hapur.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Parashtrohet rendi i ditës:

1. Projektvendim për një ndryshim në VKB Nr.60, datë 23.12.2024, "Për Miratimin e nivelit të pagave të Administratës të Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative, Institucioneve të varësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025".
2. Projektvendim mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar të Emergjencave civile me objekt: "Ndërtim muri mbajtës rruga auto, lagjia Shpoz, degëzimi djathtas (Ndërhyrje emergjente)".
3. Projektvendim "Për disa shtesa në Vendimin Nr.64, datë 23.12.2024, për buxhetin e vitit 2025".



**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Ju ftoj të miratojmë rendin e ditës përmes votimit:

- Miratohet rendi i ditës me votat e plota të këshilltarëve pjesëmarrës **me**,

**11 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**

**Pika numër 1 e rendit të ditës:** Projektvendim për një ndryshim në VKB Nr.60, datë 23.12.2024, “Për Miratimin e nivelit të pagave të Administratës të Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative, Institucioneve të varësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025”.

**Dritan Lika**, Drejtor i Zyrës së Financës:

Përshëndetje të gjithëve!

Atëherë duke marrë shkas nga nevoja emergjente, Kryetari i Bashkië ka nxjerrë një Urdhër Nr.724/1, datë 28.05.2025 ku thuhet:

Tek pika 1 e miratimit të Strukturës Organizative të Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative dhe Institucioneve Buxhetore në varesi të Bashkisë, për çdo pozicion pune në përputhje me legjislacionin në fuqi, Tabela e Struktues Organike të punonjësve të Bashkisë Fushë-Arrëz germa "D", pika "II", nënpika 85, të ndryshohet nga 2, bëhet 7 (punonjës shërbimesh për mirëmbajtje objektsh). Ne ju ftojmë të miratoni propozimin sipas Projektit bashkëlidhur dalë nga Zyra e Burimeve Njerëzore.

Sqaroj se janë shtuar 5 punonjës pasi Bashkia ka përfituar materiale nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të cilat do të përkthehen në objektë në të gjithë territorin e Bashkisë. Për të vënë në punë këto materiale është e nevojshme që të shtohen edhe 5 punonjës shërbimesh. Në këtë mënyrë përmirësohet cilësia e shërbimeve të qytetarët.

Faleminderit për vëmendjen tuaj!

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqenëse nuk ka diskutime ju ftoj të miratojmë me votë Projektvendimin për një ndryshim në VKB Nr.60, datë 23.12.2024, “Për Miratimin e nivelit të pagave të Administratës të Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative, Institucioneve të varësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025” sipas projektit dhe materialeve të paraqitura nga zyra përkatëse.

- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve Projektvendimi për një ndryshim në VKB Nr.60, datë 23.12.2024, “Për Miratimin e nivelit të pagave të Administratës të Bashkisë Fushë-Arrëz, Njësive Administrative, Institucioneve të varësisë dhe Funksioneve të deleguara për vitin 2025”, sipas projektit dhe materialit të paraqitur nga zyra përkatëse **me**,

**11 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**



**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

**Pika numër 2 e rendit të ditës:** Projektvendim mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar të Emergjencave civile me objekt: "Ndërtim muri mbajtës rruga auto, lagjia Shpoz, degëzimi djathtas (Ndërhyrje emergjente)".

**Nezir Ahmetaj**, përfaqësues i Zyrës së Emergjencave Civile:

Përshëndetje të gjithëve!

Nisur nga një kërkesë e Kryesisë së Fshatit Fushë-Arrëz me Kryetar Fshati, Z. Lek CURRI për ndërhyrje emergjente në rrugën automobilistike të lagjes "Shpoz" e cila thotë:

“Nëpërmjet kësaj kërkesë, Kryesia e Fshatit, ju vë në dijeni për gjendjen tepër të rënduar të rrugës automobilistike që përshkon lagjen "Shpoz", si pasojë e reshjeve të dendura të ditëve të fundit.

Për shkak të këtyre reshjeve, janë shkaktuar dëmtime serioze në trupin e rrugës, duke krijuar vështirësi të mëdha për qarkullimin e mjeteve dhe të banorëve, si dhe rrezik potencial për aksidente dhe izolim të zonës.

Në emër të komunitetit të lagjes dhe të gjithë banorëve të prekur, ju lutemi që Bashkia të ndërhyjë sa më parë për rikonstruksionin apo riparimin e nevojshëm të segmentit rrugor në fjalë”.

Siç e kemi theksuar edhe në Relacionin shpjegues të Projektvendimit, në segmentin rrugor auto rural Shpoz, Njësia Administrative Fushë-Arrëz ka lëvizje të terrenit, gjë e cila ndikon drejtpërdrejt në qëndrueshmërinë e trasesë së rrugës, faktor ky që ka ndikuar në prishjen e ekuilibrit të trasesë së rrugës si dhe njëkohësisht pjerrësia e shpateve dhe përbërja e formacioneve të tokës të cilat në kohë reshjesh bëhen të rrëshqitshme.

Si rezultat i kësaj situate të krijuar ekziston mundësia reale e dëmtimit të karragjatës dhe nxjerrjes së objektit jashtë funksionit.

Theksojme se kjo rrugë ka ngarkesë të madhe të lëvizjes së automjeteve ndaj duhet ndërhyrje e menjëhershme për ruajtjen dhe funksionimin normal të saj.

Grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 242 datë 04.06.2025 konstatoi situatën e krijuar në terren dhe parashikoi që për vënien në funksion të kësaj rruge nevojiten ndërtimi i një muri me gjatësi 50 m i cili duhet të ndërtohet për mbrojtjen e trupit të rrugës në vazhdimësi.

Bazuar në preventivin përkatës të ndërtimit të këtijë muri nevojitet vlera e përafërt prej 1087214 (një milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e katërmëdhjetë ) lekë.

Për të mundësuar përdorimin e kësaj vlere duhen bërë ndryshimet në buxhetin e bashkisë konkretisht në fondin e kushtëzuar të emergjencave civile i cili për vitin 2025 është në vlerën 2782861 lekë ku nga këto:

1 000 000 (një milion lekë), me objekt “Devijim i rrugës auto fshati Dardhë, Njësia Administrative Blerim për shkak të rrëshqitjes nga shirat e rëna me datë 06.09.2024, në territorin e Bashkisë Fushë-Arrëz; 400 000 (katërqind mijë lekë), me objekt “Ndërtim muri



mbajtës Çerdhja e fëmijëve Fushë- Arrëz”; 884352 (tetëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e dy), me objekt “Blerje paisjesh për MZSH-në”

Procedura këto të miratuara me Vendimin e Këshillit Nr. 50 datë 30.09.2024 dhe të konfirmuara nga Prefektuara me shkresën Nr. 699/1 prot datë 17.10.2024 por që këto fonde nuk janë përdorur në vitin 2024 për shkak të bllokimit nga ana e thesarit, me pretekstin se mbas datës 15 tetor nuk mund të bëhet asnjë procedurë standarte të prokurimeve sipas legjislacionit në fuqi. Pjesa e mbetur nga fondi i kushtëzuar i emergjencave Civile është në vlerën prej 498 509 (katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e nëntë ) lekë ku kësaj shume do ti shtohen edhe 588705 (pesësëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind e pesë) lekë të cilat do të merren nga fondi i emergjencave të bashkisë, dhe vlera totale e investimit të sipërcituar do të jetë 1087214 (një milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e katërmëdhjetë) lekë të cilat do të përdoren për të ndërtuar murin që nevojitet për rehabilitimin e këtij segmenti.

Punimet për ndërtimin e këtij muri do të monitorohen në terren nga Administratori përkatës i Njesisë Administrative dhe do të hartohen procesverbalet përkatëse për kryerjen e punimeve, i cili do dorëzohet në arshivën e Bashkisë.

Prandaj, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, neni 29, Ligjit nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, neni 30, shkronja “gj”, VKM nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, si dhe pas kërkesës së Kryetarit të Fshatit Fushë-Arrëz, Bashkia Fushë- Arrëz dhe konstatimit të grupit të punës për verifikimin e dëmit të shkaktuar në rrugën auto, lagjia Shpoz, në territorin e Bashkisë Fushë-arrëz, kryesuar nga Dod Pepa kryetar, Tonin Prenga e Silvio Pashkaj anëtarë , Sektori i Planifikimit të territorit ka hartuar një preventiv bashëlidhur edhe fotot e dëmit në këtë segment. Ndaj ne si Zyrë e Emergjencave Civile kërkojmë Këshillit Bashkiak miratimin e këtij Projektvendimi.

Duke ju falenderuar edhe në emër të Përgjegjësit të Sektorit, Ing Dod Pepa, Specialist i Zyrës së Emergjencave Civile, **Nezir Ahmetaj**.

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Nuk ka diskutime, prandaj ju ftoj të miratojmë me votë Projektvendimin mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar të Emergjencave civile me objekt: "Ndërtim muri mbajtës rruga auto, lagjia Shpoz, degëzimi djathtas (Ndërhyrje emergjente)" sipas projektit dhe materialeve të paraqitura nga zyra përkatëse:

- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve Projektvendimi mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar të Emergjencave civile me objekt: "Ndërtim muri mbajtës rruga auto, lagjia Shpoz, degëzimi djathtas (Ndërhyrje emergjente)", sipas projektit dhe materialeve të paraqitura nga zyrat përkatëse **me**,

**11 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**



**Pika numër 3 e rendit të ditës:** Projektvendim “Për disa shtesa në Vendimin Nr.64, datë 23.12.2024, për buxhetin e vitit 2025”.

**Dritan Lika**, Drejtor i Zyrës së Financës:

Përshëndetje të gjithëve! Para se të fillojmë me shpjegimin e projektit, më lejoni të sqaroj se ky projekt vjen pak me vonesë në Këshill për faktin se Kodi Zgjedhor ka disa kufizime dhe ndalesa në një periudhë të caktuar të këtij viti ku kishim Zgjedhjet Parlamentare. Është kërkuar mbledhje jashtë radhe sepse të gjitha këto janë investime duhet të prokurohen, process ky që merr kohën e vet dhe më pas bëhet problem realizimi nëse do vonoheshim më shumë.

Vendimi Nr.64, datë 23.12.2024 është Vendim i marrë për buxhetin e vitit 2025. Ky Vendim pëson ndryshime me këtë projekt pasi përdoren transfertat dhe të ardhurat e trashëguara nga viti 2024 për vitin 2025. Në vlera monetare janë: 30,748,190 lekë transfertat e pakushtëzuar e trashëguar, 23,755,217 lekë të ardhura të trashëguara, në total 54,503,407 lekë janë trashëguar nga viti 2024 për vitin 2025. Këto do të përdoren sipas programeve buxhetore të përcaktuara:

Për programin 01110 (Për Administratën e Bashkisë) do të përdoren 8,617,266 lekë;

Për programin 04520 ( Për Rrugët rurale ) do të përdoren 1,227,000 lekë;

Për programin 06260 (Për Shërbimet publike) do të përdoren 41,401,461lekë;

Për programin 10430 (Për Ndërmarrjen sociale) do të përdoren 868,000 lekë;

Gjithashtu në këtë projekt janë përfshirë edhe dy shumat që Bashkia bashkëfinancon me Ministrinë përkatëse për projektin e strehimit social lidhur me çatitë e pallateve dhe për bonuset e strehimeve. Pjesa më e madhe e këtyre fondeve, mbi 60% përdoren për investime dhe këto janë të listuara në listën e investimeve që secili prej këshilltarëve e ka në letër përpara.

Një sqarim i shkurtër: Të gjitha ato investime që fillojnë me kod përpara janë investime të vitit të kaluar të cilat nuk janë realizuar dhe janë trashëguar për vitin 2025. Ndërkohë pjesa tjetër janë të gjitha investime të reja që pritet të realizohen gjatë vitit 2025.

Një pikë është edhe shtesa e numrit të punonjësve.

Janë shtuar 5 punonjës pasi Bashkia ka përfituar materiale nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të cilat do të përkthehen në objektë në të gjithë territorin e Bashkisë. Për të vënë në punë këto materiale është e nevojshme që të shtohen edhe 5 punonjës shërbimesh.

Kjo ishte një panoramë e shkurtër e projektit që kemi paraqitur duke kërkuar miratimin e këtij projekti. Faleminderit për vëmendjen tuaj!

**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Nëse nuk ka diskutime ju ftoj të miratojmë me votë Projektvendimin “Për disa shtesa në Vendimin Nr.64, datë 23.12.2024, për buxhetin e vitit 2025” sipas projektit dhe materialit të paraqitur nga zyra përkatëse.

- Miratohet me vota të plota të pjesëmarrësve Projektvendimi “Për disa shtesa në Vendimin Nr.64, datë 23.12.2024, për buxhetin e vitit 2025” sipas projektit dhe materialit të paraqitur nga Zyra e Financës **me**,

**11 vota pro**

**0 vota kundër**

**0 vota abstenim**



**Nikolin Bardhoku**, Kryetar i Këshillit Bashkiak:

Meqë nuk kemi diçka tjetër për të shqyrtuar mbledhjen e deklaroj të mbyllur këtu.

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen ju uroj suksese dhe mirë u takofshim në mbledhjen e radhës!

**SEKRETAR**

**Naze SELIMAJ**

**KRYETAR**

**Nikolin BARDHOKU**



Besjana Marku  
Vjollca Tabakaj  
Shkëlqim Tashiri

Nikolin Sadiku

Valentin Doci  
Pavlen Ruzh  
Lind

Franc Doda  
Barthol Daga

Lerina Ceca  
Zef Ceca  
Juvu!